



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 24.01.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.01.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "**PRIMO STUDIO**" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Hartimi i projekteve të ndërtimit të lartë**", Nr. i prokurimit- 632-23-13950-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-195-211, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "**PRIMO STUDIO**" SH.P.K., e dt.19.01.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Hartimi i projekteve të ndërtimit të lartë**", Nr. i prokurimit- 632-23-13950-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-195-211, kundër **DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË**, të publikuar me datë 14.12.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Përmirësohet** pjesërisht DOSJA E TENDERIT, e publikuar me datë: 14.12.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "PRIMO STUDIO" SH.P.K., me dt.19.01.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve të ndërtimit të lartë", Nr. i prokurimit- 632-23-13950-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-195-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 24.01.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Lidhur me pretendimin e juaj të parë sqarojmë se për "*Një personel të certifikuar për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis (VNM)*" (pika 9) - duhet të jetë personel / ekspert i veçantë i fushës, ndërsa për: "*Një Auditor për Energji Eficiente në Ndërtesa* (pika 8) dhe *Një personel me provim profesional në lëmin e mbrojtjes nga zjarri (certifikatë nga AME) si dhe autorizimin nga AME për hartim të projekteve (elaborateve për mbrojtje nga zjarri)*" (pika 10) - pranohet edhe personel - inxhinier, i cili ka edhe licencë për njërin nga dy fushat e përshkruara (një inxhinier + një licencë e jo një inxhinier e dy licenca), prandaj ky pretendim i juaji është pjesërisht i bazuar;
- Pretendimi juaj i dytë nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues, do të caktoj shtyerjen e afateve kohore në përputhje me LPP-në.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

